



13:53 - 11 Qershor, 2021

f

t

s

Biznesit të ish-ministrit të Mjedisit, Lefter Kokës në Durrës i është vendosur tritol me dron. Ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë në kantinën e pijeve “Gjergj Kastrioti”. Uniformat blu bëjnë me dije se nga shpërthimi i lëndës eksplozive janë shkaktuar dëme të vogla materiale.

Policia njofton se kanë kapur autorin e dyshuar, Gentian Meta 44 vjeç, banues në Shijak. Sakaq, është arrestuar edhe B. Z., 34 vjeç, banues në Shetaj, Durrës, menaxher i lokalit në pronësi të autorit pasi nga kontrolli i ushtruar në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë, me një karikator me 7 fishekë luftarakë.

Gjithashtu është proceduaar penalisht edhe vëllai i autorit të dyshuar të ngjarjes, A. M., 46 vjeç, banues në Shijak, pasi nga kontrolli i ushtruar në banesën e tij në Shijak iu gjet një sasi vere me logon e një subjekti tjetër, veprime këto që bien ndesh me vendimin e gjykatës.

Lefter Koka ishte i shtati në listën e Partisë Socialiste në Durrës në zgjedhjet e 25 prillit dhe arriti të fitojë mandatin e deputetit.

Njoftimi i policisë:

Vendosi lëndë eksplozive në një objekt biznesi, identifikohet dhe arrestohet në flagrancë nga Policia.

Vihet në pranga edhe menaxheri i lokalit në pronësi të autorit të dyshuar, pasi nga kontrolli në mjetin e tij Policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri pistoletë.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, menjëherë pas njoftimit të marrë për shpërthimin e një sasive të vogël lënde eksplozive të hedhur mbi terracën e një godine trekatëshe, objekt biznesi, në pronësi të shtetasit J. D., në lagjen nr. 14 Durrës, kanë organizuar punën dhe falë veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale, bënë të mundur identifikimin, kapjen dhe arrestimin e autorit të dyshuar, shtetasit: G. M., 44 vjeç, banues në Shijak.

Nga shpërthimi i lëndës eksplozive janë shkaktuar dëme të vogla materiale.

Në vijimësi të veprimeve hetimore u arrestua në flagrancë dhe shtetasi B. Z., 34 vjeç, banues në Shetaj, Durrës, menaxher i lokalit në pronësi të shtetasit G. M., pasi nga kontrolli i ushtruar në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë, me një karikator me 7 fishekë luftarakë.

Gjithashtu në vijim të veprimeve u procedua penalisht edhe vëllai i autorit të dyshuar të ngjarjes, shtetasi A. M., 46 vjeç, banues në Shijak, pasi nga kontrolli i ushtruar në banesën e tij në Shijak iu gjet një sasi vere me logon e një subjekti tjetër, veprime këto që bien ndesh me vendimin e gjykatës.

Në përfundim të veprimeve procedurale, materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në ngarkim të shtetasit G. M., për veprat penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, “Kanosja”, “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit”; në ngarkim të shtetasit B. Z., për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit “dhe në ngarkim të shtetasit A. M. për veprat penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”.

g.v/abcnews.al

AktualitetLefter Koka

Të ngjashme

- A i ka PS 94 vota?
Lista e deputetëve që pritet të votojnë për... shkarkimin e Ilir

Elona Guri kallëzon djalin e Lefter Kokës: Vuri përgjues te zyra... e LSI dhe kërcënonte

Përplasja LSI-Koka, Artan Hoxha ngre pikëpyetjen: Jam i... shqetësuar, pse po

f

t

s

- 23:42 - 16 Qershor, 2021

Çunat e parlamentit fluturojnë drejt Londrës
- 23:22 - 16 Qershor, 2021

Plagoset me armë zjarri një person në Pejë
- 23:21 - 16 Qershor, 2021

Zgjerohet harta e gripit të shpendëve në Shqipëri,...
- 23:08 - 16 Qershor, 2021

Gjermania tërheq një togë nga misioni i NATO-s në Lituani
- 19:58 - 16 Qershor, 2021

Artan Hoxha zbulon lagjet e “nxehta” në Shkodër ku mësyu...
- 16:48 - 16 Qershor, 2021

Mjekët apel të rinjve: Mos shkoni në plazhe nëse ke...
- 16:47 - 16 Qershor, 2021

Ngushtohet laku, kush janë tre shqiptarët e...
- 11:57 - 16 Qershor, 2021

BE heq kufizimet e udhëtimit për shqiptarët, çfarë...